

FUNDAMENTALIZMI ISLAM

DOMETHËNIA E FJALËS FUNDAMENTALIZËM ?

Nese konsultojme fjaloret dhe leksikonet e ndryshem termin fundamentalizem nuk do ta hasim aspak, qofte ne kuptimin etimologjik ose ne kuptimin terminologjik. P.sh. ne fjalorin e fjaleve dhe shprehjeve te huaja e hasim keshtu: **Fundamentum**; qe do te thote: themel, baze, rreze. Ose **fundamntal**: themelor, bazor. Kurse në fjalorin Amerikan New Websters dictionary of English language i botuar në Çikago dhe në New York në vitin 1975 në faqen 199 thotë: " Fundamentalizmi është fjalë latine fundamentum që do të thotë bazë, themel. Ndërsa në kuptimin terminologjik do të thotë: Është besim se bibla duhet të pranohet si një dokument i pagabuar, pra është një lëvizje fetare që u themelua në fillim të shekullit XX në Amerikë .

Fundamentalizmi si lëvizje fetare e protestantëve t'Amerikës u shfaq si kundërshtim ndaj liberalizmit ekstrem dhe modernizimit të bashkësive fetare krishtere t'Amerikës dhe Anglisë. Kjo shpjegohet dhe dëshmohet me faktin se në enciklopedinë më të madhe teologjike katolike **Sakramentum** të vitit 1967 - 1969 botimi italishtë në tetë vëllime, ky termin nuk përmendet fare.

Ne kuptimin semantik te fjales **fundamentalizëm** *do të kuptohim*.: rrikthim në bazat e fesë, aplikimi i rregullave fetare mu ashtu siç janë shpallur nga All-llahu xh.sh.

Ne orientalistikë termi *fundamentalizëm* perdoret i devijuar, i indoktrinuar sipas politikës aktuale të ditës dhe në fakt orientalistët janë të parët të cilët si duket përdorën termin *fundamentalizëm islam*. Fatëkeqsisht teza e gatuar në këtë formë në të kaluarën më të afërt filloi të përdoret edhe nëpër qarqet e ndryshme të politikës botërore.

Burimi tjetër i termit *fundamentalizëm Islam* si duket është edhe pseudointeligjencia Islame e shkolluar nëpër katedrat e islamistikës në Perëndim. Mu nga kjo gjatë shekullit njëzet në botën Islame lindin fraksione të shumta qoftë në kuptimin fetar, te jetes fetare, kultures fetare, jetes politiko-fetare etj. Andaj tani në radhët e

muslimanëve paraqiten "**modernistët**" Islam dhe "**Orthodoksët**" Islam. Në fund në një tërmet të këtillë, disa intelektual muslimanë deshtën që me të vërtetë të bëjnë një rikthim të vërtetë, të pastër në jetën fetare Islame të mbështetur në burimet Hyjnore, në Kur'ani Kerim dhe në Sunnet, për fat të keq këta u quajtën fundamentalistë në kuptimin politik të fjalës.

Të rrumbullaksojmë termin fundamentalizëm: secila fe ka fundamentet e veta, siç ka secila shkencë fundamentet e veta. P. sh. do të thoshim se fundamentet e Islamit janë këto...; fundamentet e krishterizmit janë këto...; fundamentet e një ideologjieje janë këto.... Ndërsa njeriu i cili i aplikon - i vë në shërbim ato fundamente është fundamentalist. Çfarrë rreziku ka këtu?! Mendoj se njeriu i cili iu përmbahet fundamenteve të cilave iu ka besuar, ai është njeri me plotë kuptimin e fjalës, përndryshe ai do të ishte laik, mosnjohës i lëmis së vetë, si shkenctar, teolog, ose i cilës lëmi qoftë.

Ku dhe kur për herë të parë në hapsirat tona u lansua teza për ekstremizmin e fundamentalizmit Islam dhe sa ka të bëjë kjo me të vërtetën?

Ideja për fundamentalizmin Islam lindi kah vitet e tridhjeta. Sipas ca të dhënave muslimanët për herë të parë sulmohen si fundamentalistë militantë në vetë shtetet e ashtuquajtura Islame si në Egjipt, Siri, Palestinë, Irak etj. Fatëkeqësisht që sulmi i këtillë filloi nga pushtetëmbajtësit e atëhershëm. Nëse hollësisht analizojmë këtë fenomen, mbase do të vijmë në përfundim se ideja e fundamentalizmit me konotimin politik është pjellë e kolonialistëve dhe imperialistëve, sidomos e kolonialistëve cionistë.

Pas luftës së dytë botërore fundamentalizmi Islam, thënë kushtimisht, në qendër të vëmëndjes ka qenë në Egjipt, Indonezi por edhe në pjesën veriore të Afrikës sepse ekzistonte frika se mos vallë pushtetin do ta marrin në duar të veta teistët përkundër idesë ateiste-marksiste e cila gjatë kësaj kohe përjetonte revolucionin "shkencor" dhe politik edhe në këtë pjesë të botës.

Duke filluar nga vitet e shtatëdhjeta muslimanët e ishjugosllavisë në mënyrë vetanake organizojnë jetën fetare dhe kulturore. Në këtë drejtim Bashkësia Islame arriti që me të vërtetë të organizojë jetën fetare dhe kulturore të besimtarëve të vetë në forma të ndryshme por fatmirësisht jo jashtë sistemit dhe legjislaturës

aktuale. Një organizim i këtillë i popullatës Islame që në fillim të viteve tetëdhjeta i pengonte politikës së ditës. Andaj te intelektualët komunistë intuitivisht lindi frika nga pjesëtarët e Islamit se mos vallë në një ardhmëri të afërt ca troje të shtetit mos po shndërrohen në shtete fetare sidomos Islame. Në veçanti theksoj Islame sepse edhe pse shteti i atëhershëm proklamonte njëfarë socializëm-komunizëm, në esencë ruanin kulturën e vetë kishtare, kuptohet në formë oportuniste ose më mirë të them jopublike. Shih, që frika t'ju hyjë në palcë, e imagjinuan edhe njëfarë *fundamentalizmi humejnian*, pasi që këto janë vitet e revolucionit të ri Islam në Republikën Islame të Iranit.

Tensionet me përmbajtje politike kohë pas kohe shtoheshin ose dobësoheshin varësisht nga aktivitetet e muslimanëve në trojet e ishjugosllavisë. Edhe pse aktivitetet gjithmonë kanë patur përmbajtje fetare dhe shpirtërore, shpeshherë nga politika ditore trajtoheshin si aktivitete politike. Mu për këtë, ndodhivë të viteve të tetëdhjeta në Republikën e Kosovës dhe procesit të montuar në Sarajevë në vitin 1983 iu dha ngjyra fundamentaliste Islame me qëllim që të realizohen elaboratet dhe projektet e vjetra dhe të rejtat të serbosllavisë.

Nga e tërë kjo restrospektivë e shkurtër në ardhmërinë më të afërt politika e medimeve maqedonase jorastësisht popullatën muslimane në Maqedoni e akuzon për fundamentalizëm. Mbase, sipas mendimit tim një politizim i këtillë është i vonuar dhe i panevojshëm për aktualitetin në vetë Republikën. Mos vallë këtu fjala është për mbjelljen e frikës në marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe ndërfitare! Apo mos vallë aktualizimi i fundamentalizmit në këto troje ka për qëllim acarimin e gjendjes edhe ashtu mjaftë të tendosur dhe faji përsëri t' u mbetet pjesëtarëve të Islamit siç është rasti me Bosnjë e Hercegovinën!? Qëllimi i dytë me siguri do t' i kishte përkujtuar "shtrigës së madhë" që të jetë më e kujdesshme ndaj jomuslimanëve sepse ju "rrezikohet" jeta dhe kështu me radhë.

Mos vallë "fundamentalizmi Islam" është sinonim i frikës së panevojshme nga përhapja e Islamit, e që në mënyra të ndryshme manifestohet si me vënien e kryqave nëpër objektet historike si dhe nga reagimet lidhur me ezanin që dëgjohen nga xhamitë?

Ku nuk ka siguri fizike ose shpirtërore, ka frikë, dhe e kundërta, ku ka frikë nuk ka siguri. Mirëpo, pavarësisht nga frika e përhapjes së Islamit, Islami po përhapet, edhe atë fatmirësisht në tërë botën e në veçanti në Perëndim. Përhapja e Islamit në botë është çështje e All-llahut xh.sh. e jo e njeriut. All-llahu xh.sh. këtë e garanton: **"Ne me të vërtetë e kemi Shpallur Kur' anin dhe padyshim ne jemi mbrojtësit e tij"**. [El-Hixhër, 9]

"Ata dëshirojnë që me gojët e tyre të shuajnë dritën e All-llahut, kurse All-llahu don ta përsos dritën e vet, edhe pse mosbesimtarët e urrejnë. Ai është i cili ka dërguar Pejgamberin e vet me udhëzim dhe fe të drejtë për ta shquar mbi të gjitha fetë, edhe pse politeistët e urrejnë."[Et-Tevbe, 32, 33]

Krahas kësaj njeriu duhet patjetër në mënyrë dinjitoze të veprojë dhe të luajë rolin të cilin A-llahu xh.sh. ia fali në këtë botë.

Unë plotësisht kuptojë problemet (kokçarjet) që i ka R e Maqedonisë, mirëpo, assesi nuk mund të kuptojë mënyrën se si mundohemi t' i zgjidhim problemet. Sidomos nuk mund të kuptojë sjelljen e instancave të ndryshme ndaj thesarit kulturor. Sipas mendimit tim këtu fajin kryesor e mban pala tjetër. Nuk mund të kuptojë edhe pse jam munduar që në mënyrë objektive të pranoj një veprim të tillë, se si kisha maqedonase mbetet e shurdhër ndaj këtij akti ndërsa, në takimet zyrtare gjithmonë na ofron bashkëpunim të ndërsjellë. Nga sjelljet e këtilla vi në përfundim se akti i këtillë kryhet nga disa subjekte e jo nga një subjekt, por kam frikën se mos vallë këtu ka dorë edhe ndonjë element tjetër jashta Maqedonisë. Mirëpo, jam ma se i bindur se kryqi nuk e ka vendin në kullën e sahatit pa marë parasysh se ku ndodhet kulla bile në aspektin historik dhe kulturor. Një sjellje e këtillë është në dëm të atyre që e venduan, dhe kurrdo, besoj se kryqi do të gjejë vendin e vet.

Unë me të vërtetë nuk mund të kuptojë politikën e medimeve maqedonase. Më vjen shumë keq se nën këtë nënqiell edhe më tej vazhdon, si duket, sistemi bollsheviko-komunist. Të akuzosh tjetrin patjetër duhet të keshë argumente. Fatmirësisht, një ditë të shtune, para dhjetë ditësh përcolla ditarin e dytë në TV. Në reportazhin e z. Lubomir Boshkovskit nuk pash asnjë argument përveçse insinuatave dhe shpifjeve. Autori sipas të gjitha gjasave don të fut huti ndër maqedonasit dhe t' i frikësojë ata, kisha thënë **"nga xhihadi i Lubomirit"**

Jam ma se i bindur se askujt nuk i pengon ezani muhamedije, aq i bukur. Ndoshta ju pengon hipokritëve, por pabesimtarëve assesi pasi që ata nuk e kanë për borxh të falin pesë kohët e namazit. Mos vallë zotëriu dëshiron që edhe pjesëtarët e Islamit të ndërtojnë faltoret e tyrë nëpër male!? Jo, faltoret ju shërbejnë njerëzve dhe askujt tjetër. Nëse dikush zërin e njeriut e trajton si zhurmë, atëherë do të parashtrosha pyetjen: ku janë mediumet maqedonase si dhe organet kompetente që nuk marrin masa kundër automjeteve dhe motorëve të atyre që me qëllim të aventurës na e prishin qetësinë në mes të natës ose rreth mëngjezit? Ose mos vallë autoparlantët e dyqaneve të ndryshëm duam që të gjithë t' i dëgjojmë! Jam i bindur se dhe pjesëtarët e fesë tjetër nuk janë kundër ezanit që jepet në minare, përkundrazi të gjithë jemi kundër kaosit dhe politizimit të ibadeteve (riteve) fetare.

Vitin e kaluar në Sarajevë u mbajtë një tryez shkencore në temën "fundamentalizmi Islam" Aty gjithashtu morët pjesë edhe ju. Çka u tha dhe çka u konkludua në këtë tryez?

Në fund të vitit 1989 në Sarajevë u organizua një tubim shkencor në temën "Fundamentalizmi Islam, çka është ky"? Tubimin e organizoi gazeta "Preporod" dhe revista "Islamska Misao". Në këtë tubin krahas teologëve morën pjesë shkencëtarë të lëmive të ndryshme nga muslimanët dhe të tjerët. Biseda që u zhvillua ishte mjaftë konstruktive por në veçanti më pëlqeu:

-dr. Josip Bariçeviqi, profesor në fakultetin teologjik të Zagrebit,

- Daniel Bučan, publicist i njohur nga Zagrebi,

-dr. Halid Çausheviq, jurist dhe historian nga Sarajeva,

-dr. Zdravko Grebo, profesor në fakultetin juridik në Sarajevë,

- dr. Hasan Sushiq, profesor në fakultetin e shkencave politike në Sarajevë etj.

Përfundimi i të gjithë pjesëmarrësve ishte se fundamentalizëm në kuptimin shkencor dhe thelbësor patjetër secili duhet të ketë, përndryshe ne nuk do të ishim këta që jemi. Por, fundamentalizëm në kuptimin ideologjik politik kundër rendit shtetëror në trojet e ishjugosllavisë nuk mund të ketë dhe nuk ka.

Ne si shkencëtarë si dhe bashkësitë fetare duhet të veprojmë në mënyrë të pavarur nga politika e ditës sepse ajo është kalimtare dhe

se burrat e shtetit në veçanti dhe popujt tanë nëpërgjithësi nuk duhet aspak të frikësohen nga fundamentalizmat e ndryshëm sepse të jemi të bindur se vetëm në atë mënyrë do të mund të njifemi dhe të ruajmë thesarin tonë fetar dhe kulturor.

Si e shpjegoni përkrahjen masovike dhe fitoret e partive proislamike në Algjer, Liban dhe lëvizjet e ngjashme në Egjipt?

Me ramjen e sistemit totalitar komunist në tërë botën dhe në veçanti në Bashkimin Sovjetik, në arenën botërore u hapën dyertë e mendimit të lirë. Të jemi të qartë se disa shtete në botën arabe heshtazi kanë qenë prokomuniste ose prosocialiste, përndryshe nuk do të formoheshte lëvizja e shteteve të pavarura (të painkuadruara). Mirëpo, pasi që kjo ideologji u shkri të njëjtat shtete e kanë vështirë të gjejnë zgjidhje për rregullimin shtetëror të brendshëm. Nëse këtu kemi parasyshë kolltuqet e burrave të shtetit dhe dëshirën e popullit është ma se e arsyeshme që disa shtete arabe të kenë kokçarje të brendëshme. Me siguri se mosmarëveshjet lindin në mes të pushtetmbajtësve dhe popullit. Unë jam nga ana e popullit sepse atyre u takoj, përndryshe nuk do të kisha kryer obligimin tim qoft si njeri qoftë profesionalisht si hoxhe.

Algjeri dhe Libani kanë qenë koloni të Francës. Mendoj se kolonialistët kanë lëshuar rrënjët e veta, dhe tani kur në botë mbjellen sisteme të reja për rregullimin shtetëror është mjaft e arsyeshme që të plotësohen dëshirat e popujve autokton. Është absurd që ata popuj të mos jenë në gjendje të udhëheqin vetveten dhe besoj se ka njerëz të aftë në çdo pikëpamje të mëvetësohen. Do të thoni se ata janë shtete të pavarura dhe anëtare të OKB. Jo, nuk është e vërtetë se ata janë të mëvetësuara. P.sh. në Algjer deri para katër pesë vitesh gjuha zyrtare ka qenë gjuha frenge bile edhe gjuha e mësimit, atëherë si janë të mvetësuara kur popullata e atjeshme janë arab?

[Intervistë e dhënë RTV redakcia e gjuhës shqipe në vitin 1993 dhe tribuna të organizuara nga: Këshilli i Bashkësisë Islame në Tetovë, tribuna e organizuar nga PAD-Rruga Islame në Tetovë dhe në tribunën e organizuar nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Shkup. Teksti gjithashtu është botuar edhe në gazetën "Hëna e re" Organ i Meshihatit të BI në Maqedoni]